



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:086658
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05724512

AA.nr.651/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, R.R, Komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Egzona Gashi, avokate nga Lipjani, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1045/22, të datës;04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, R.R, Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1045/22, i datës;04.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1045/22, të datës;04.07.2023, është vendosur, *“I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpafia e paditësit R.R, komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Egzona Gashi, avokate nga Lipjani, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 40 të datës 04.03.2022 të marrë nga e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi, përmes të autorizuarës së tij, Egzona Gashi avokate nga Lipjani, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit dhe aktgjykimi i goditur të ndryshohet në favor të paditësit duke aprovuar kërkesëpadinë ose aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë; 28.04.2022, kundër vendimit të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me çka kërkuar nga Gjykata anulimin e vendimit nr.40 të datës 04.03.2022. Paditësi konsideron se me vendimin e goditur me padi, organi i paditur nuk i ka aplikuar drejtë dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative ngase i njëjti nuk është hartuar në kuptim të nenit 48 të LPPA-së, se ka zbatim të gabuar të ligjit material dhe se fakti që personi i vdekur nga Covid 19 nuk figuron në listat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nuk paraqet fakt relevant sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, andaj i propozon Gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin padia aprovohet si e bazuar dhe anulohet vendimi i të paditurës..

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se *“Gjykata i shqyrtoi dhe vlerësoi si të drejta dhe të sakta konstatimet faktike të të paditurës se në bazë të shkresave të lëndës paditësi nuk ka provuar para organit të paditur se i njëjti ka vepruar konform pikës 1.A të vendimit Nr.58/2021 pasi që personi i vdekur nuk kishte figuruar në listat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe se dokumenti i lëshuar nga institucionet publike të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, gjykata gjeti se kërkesat ligjore që dalin nga pika 1.A e vendimit Nr.58/2021 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 28.09.2021, të ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.58-1 të datës 12.11.2021 si dhe Vendimin Nr.58-2 të datës 22.11.2021, janë kërkesa specifike, mosplotësimi i së cilave me të drejtë ka rezultuar në refuzimin e ankesës së paditësit. Kështu, gjykata hodhi poshtë pretendimet e paditësit se: “familjarët e të vdekurit nuk janë fajtor për shkak të mos komunikimit të Institucioneve të Republikës së Kosovës me Institucionet shëndetësore që veprojnë dhe punojnë në enklavat serbe”, për faktin që rendi juridik i Kosovës njeh vetëm Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar kështu njohjen apo organizimin shëndetësor të çfarëdo entiteti apo enklave, të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se qëndrimi i të paditurës dhe bazueshmëria ligjore është plotësisht e bazuar në legjislacionin përkatës, në prova dhe fakte mirë të provuara. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë. Prandaj Gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.”*

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata

e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, konkretisht dispozitave nenit 182 paragraf 2 pika n), sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të këtyre dispozitave për faktin se aktgjykimi është i kuptueshëm përmban arsyet dhe faktet vendimtare, nuk ka kundërthënë ndërmjet provave që gjinden në shkresat e lëndës, është çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe se aktgjykimi i ankimuar është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, se “Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj, në pjesën e arsyetimit ka konstatuar se paditësi për shkakun e vdekjes së bashkëshortes së tij nuk ka raport të lëshuar nga institucioni publik i Kosovës. Mirëpo është fakt botërisht i njohur se komuniteti serb që nga viti 1999 e këtej, shërbimet mjekësore i kryen në institucionet që ofrojnë shërbime mjekësore në Graçanicë, Mitrovicë të Veriut, Llapnasellë dhe në të gjitha komunat ku jetojnë pakicat serbe”. Kolegji i apelit duke i vlerësuar këto pretendime ankimore, vëren se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kur ka konstatuar se “Gjykata i shqyrtoi dhe vlerësoi si të drejta dhe të sakta konstatimet faktike të të paditurës se në bazë të shkresave të lëndës paditësi nuk ka provuar para organit të paditur se i njëjti ka vepruar konform pikës 1.A të vendimit Nr.58/2021 pasi që personi i vdekur nuk kishte figuruar në listat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe se dokumenti i lëshuar nga institucionet publike të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, gjykata gjeti se kërkesat ligjore që dalin nga pika 1.A e vendimit Nr.58/2021 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 28.09.2021, të ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.58-1 të datës 12.11.2021 si dhe Vendimin Nr.58-2 të datës 22.11.2021, janë kërkesa specifike, mosplotësimi i së cilave me të drejtë ka rezultuar në refuzimin e ankesës së paditësit”.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij ankimore, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, konkretisht në pikën 1.A të vendimit Nr.58/2021 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 28.09.2021, të ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.58-1 të datës 12.11.2021 si dhe Vendimin Nr.58-2 të datës 22.11.2021.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.651/2023, datë;20.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti